

VENDIM
Nr. 663, datë 21.9.2016

PËR NDRYSHIMIN, ME SHKËMBIM NOTASH, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5 POLIKLINIKAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ndryshimin, me shkëmbim notash, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Ambasada e Italisë
Tiranë

Tiranë, më 9.5.2016
Prot. 1849

NOTË VERBALE

Ambasada Italiane në Tiranë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë dhe në emër të qeverisë italiane ka nderin t'i referohet Notës Verbale të Ministrisë Shqiptare së Shëndetësisë me nr. prot. 1683, e datës 23 mars 2016, me anë të së cilës propozohet ndryshimi i shtojcës 2 të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave”, nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2004.

Ambasada Italiane në Tiranë ka nderin të komunikojë, që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar ka pranuar, në emër të qeverisë italiane, të ndryshojë marrëveshjen e lartpërmendur, në bazë të nenit 13 të saj, si më poshtë specifikohet:

“Emërtimi “*Ministria e Punëve të Jashtme*” zëvendësohet me “*Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar*””.

Shkurtimi “MAE” zëvendësohet me shkurtimin “MAECI”.

Shtojca 2 - Kontratë shërbimi, furnizimi dhe punësh (kushtet e veçanta).

Fjala e paragrafit të dytë: “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kostot lokale dhe/ose vendeve në zhvillim, nuk mund të kalojë 45% të kredisë*” zëvendësohet me frazën “*Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorur për kosto lokale dhe/ose vendet OCSE, nuk mund të kalojë 70% të kredisë*”.

Në pajtim me përcaktimet e neneve 13 dhe 14 të marrëveshjes së mësipërme, ndryshimet e lartpërmendura do të hyjnë në fuqi nga data e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet e parashikuara me të cilat palët nënshkruese do t'i komunikojnë zyrtarisht njëra-tjetrës përfundimin e procedurave kombëtare të ratifikimit të para-shikuara sipas nevojës.

Ambasada Italiane në Tiranë përfiton nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë ndjenjat e konsideratës së saj më të lartë.

(Vulë dhe firmë)

Për dijeni: Ministrisë së Shëndetësisë
 Kryeministrisë
 Ministrisë së Punëve të Jashtme
 Ministrisë së Financave
 Tiranë